

Nga Patricia Bosquin-Caroz

Dashuritë që dhembin

Titulli, « Dashuritë që dhembin », [les amours douloureuses] tingëllon njëlloj si dashuritë e pafata [les amours malheureuses]. Ai mbart dimensionin dramatik, ndonjëherë deri tragjik të dashurisë apo të dashurive. Fjala « dhemb », nga ana e saj, lë të nënkuptohet tonaliteti ekstrem i vuajtjes që përjetohet. Kështu, disa emocione, si trishtimi, janë shenja të një gjëndjeje shqetësimi, ndërsa disa të tjera, si angështia, sinjalizojnë kapërcimin e kufirit të asaj që mund të konsiderohet e durueshme. Frojdi e vendoste në qendër të problematikës së vuajtjes psikike tensionin midis parimit të kënaqësisë dhe atij të përtej parimit të kënaqësisë. Lakani, nga ana tjetër, hodhi dritë mbi një lloj kënaqësie të pazakontë, një përzierje e kënaqësisë me dhimbjen, ku piciret e dashurisë rreshtohen nën një larmi formash: pritje, privim, dalldisje, dhembshuri, varësi, arrati, vërdallosje, xheloz, etj. Së fundmi, titulli i veprës së Sophie Calle mbi zinë e dashurisë, *Dhimbje e shijshme*, na tërheq vëmendjen me një kënaqësi paradoksale të kësaj dhimbjeje.

Duke u nisur nga qasjet e ndryshme të Lakanit ndaj dashurisë në mësimet e e tij, pa lënë mënjanë kontributin e Frojdit, është rradha jonë të eksplorojmë spiralet e dashurive që dhembin.

Mungesë, zhgënjim dhe trishtim

Në Seminarin *Le transfert* Lakani vendos në zemër të çështjes së dashurisë, funksionin e mungesës. Ai bën një përkufizim: dashuria është të japësh atë që nuk e ke¹. Në të njëjtën kohë, ai nënvizon se ajo që i mungon njërit nuk është ajo që i mungon tjetrit: asimetria midis dy partnerëve përbën problemin e dashurisë. Lakani thotë se « mjafton që të jesh i përfshirë në një situatë të tillë, mjafton të jesh i dashuruar për ta gjetur veten në këtë hendek, në këtë diskordancë.² » Por pikërisht sepse nuk ekziston një lidhje mes dëshirës dhe objektit të saj, kuptimi i dashurisë përftohet në fund të një procesi të veçantë: metaforës së dashurisë. Dhe në këtë pikë mund të shquajmë premisat e një pohimi që Lakani do të bënte disa vite më vonë:

¹ Cf. Lacan J., *Le Séminaire*, livre VIII, *Le transfert*, texte établi par J.-A. Miller, Paris, Seuil, 1991, p. 46.

² *Ibid.*, p. 53

dashuria plotëson mungesën e raportit seksual. Metafora e dashurisë ka të bëjë me rastësinë. Kur ajo ndodh, është një mrekulli, në të kundërt ka vetëm zhgënjim apo keqardhje. Tek *Banketi* i Platonit, skena që bën Alcibiadi dëshmon për zhgënjimin që ai ndien kur Sokrati i refuzon dhuratën e bërë në shenjë dashurie. Sokrati nuk dashuron, pohon Lakani, duke u treguar mjaft i vëmendshëm ndaj vlerës dhe impaktit që mund të ketë një shenjë dashurie kur ajo i adresohet qënies.

Lakani është kundër konceptimit të dashurisë si ajo që *mbledh, grumbullon, asimilon, bën bashkë* qënie që plotësojnë njëra tjetrën. Ai e përzë këtë iluzion emocional të dashurisë fuzionale që i afrohet formës ideale të një sfere. Ai vëren, po ashtu, që ky lloj *dakordësimi emocional* ndaj formave të tilla të plota i ka rrënjët në strukturën imagjinare dhe në atë që quhet « *Verwerfung* i kastrimit³ ».

Lakani i referohet gjithashtu Frojdit për të cilin, themeli i dashurisë është *Lust- Ich* dhe dashuria vetë është një efekt narcisizmi⁴. Kështu, në Seminarin *La logique du fantasme*, ai jep këtë formulë : « *Ti nuk je gjë tjetër veç asaj që unë jam. Ti nuk je, pra as unë nuk jam* »⁵. Apo një tjetër : « *Nëse ti nuk je, unë vdes* »⁶. Një e vërtetë, thotë ai, që i jep kuptim erosit dhe që nëse hidhet poshtë rishfaqet në reale në formën e një « monstre, pasojat e së cilës në jetën e përditshme ne i njohim mjaft mirë ». Dhe Lakani vazhdon : « Po them se për çdo *Verwerfung* [...], dashuria shfaqet në reale me efekte nga më shqetësueset dhe nga më deprimueset. Rrugët e dashurisë nuk mund të shihen asnjëherë si të shtruara.⁷ » Ai thekson se dashuria nuk mendon. Thënë ndryshe, dashuria refuzon të njohë fantazmën narcisike mbi të cilën mbështetet. Dhe atëherë ajo mund të veshë ngjyrat e depresionit apo të trishtimit pasi këto emocione dëshmojnë refuzimin apo hedhjen poshtë të dijes së pavetëdijshme.

Në tekstin e tij *Télévision* Lakani e lidh trishtimin, në mënyrë direkte, me një dështim moral që, në fund të fundit, thotë ai, « lidhet me mendimin apo detyrën për të thënë atë që duhet, për të gjetur rrugën e duhur në raport me të pavetëdijshmen, me strukturën⁸ ». Ai ia shkëput ndjenjën rregjistrit emocional për ta artikuluar me etikën e të thënit të asaj që duhet, « gjë që

³ Lacan J., *Le Séminaire*, livre VIII, *Le transfert*, op. cit., p. 115.

⁴ Lacan J., *Le Séminaire*, livre XIV, *La logique du fantasme*, texte établi par J.-A. Miller, Paris, Seuil, 2023, p. 157.

⁵ *Ibid.*, f. 144.

⁶ *Ibid.*, p. 157.

⁷ *Ibid.*, p. 144.

⁸ Lacan J., « *Télévision* », *Autres écrits*, Paris, Seuil, 2001, p. 526.

konsiston në qëndërzimin, në përcaktimin në dije të asaj që nuk mund të thuhet⁹ ». Ndërkohë që trishtimi, thotë Jacques-Alain Miller, është një dije që mungon.

Në të njëjtin vit, në « *Note Italienne* », Lakani do të shprehte dëshirën e tij, në lidhje me psikanalizën, që të mund « të rritë burimet, falë të cilave ne mund t'ia dalim edhe pa atë marrëdhënie fatkeqe dhe ta bëjmë dashurinë më të denjë se sa dërdëllitjet pa fund, në të cilat është katandisur ajo sot¹⁰ ».

Dashuri dhe ligjërimit

Por promovimin e dashurisë fatkeqe reciproke, nën formën e dashurisë kalorsiake, nuk do ta shihnim para Mesjetës. Lakani e lidh shfaqjen e kësaj forme të dashurisë me rastësinë e takimit midis herezisë katere dhe poezisë së re lodruese. Për të, dashuria pasionante është së pari një fakt ligjërimit që nuk vjen rastësisht në një epokë të tillë. Ai e cilëson atë si një « ëndërr të keqe të pamundur që quhej feudalizëm » ku « nga ana e gruas kishte diçka që nuk mund të funksiononte më ¹¹ ». Gjatë seminarit të tij *Encore*, ai e konsideron këtë risi të ligjërimit si mënyrën e vetme për burrin, ku Zonja, tërësisht subjekt i tij, mund « të tërhiqej nga historia nëpërmjet elegancës së mungesës së raportit seksual ¹² ». Nga ana tjetër burrit nuk i ngelej tjetër veç idealizimit të Zonjës dhe vlerësimit të paarritshmërisë së saj, ndërkohë që ligjërimit i dashurisë mëkohej me mungesën, zinë, humbjen, vdekjen. Në seminarin e tij *L'éthique de la psychanalyse*, Lakani vë në dukje saktësinë e « organizimit arifical, artificin e shënjesht ¹³ », të këtij ligjërimit që në një moment të caktuar vendos kuadrin e këtij asketizmi. Pezullimi i dëshirës së trupit, sjellja evituese dhe paarritshmëria e objektit përbëjnë, në këtë rast, disiplinën e kënaqësisë apo të pakënaqësisë. Këtë e provon arbitrariteti i kërkesave të sprovave që Zonja i impononte pretendentit të saj, jo pa një farë mizorie. Lakani vë në dukje, veç të tjerash, që praktikën dashurore më askete frymëzoheshin nga *Arti i të dashuruarit* të Ovidit që e krahasonte dashurinë me një lloj shërbimi ushtarak. Paralelisht ai nënvizon ndikimin vendimtar të shënjesht dhe aplikimin e këtij arti të dashuruarit në kulturë. Dashuria romantike që do të vinte më pas do të shënjestonte një formë ringjalljeje.

⁹ Miller J.-A., « Les affects dans l'expérience analytique », *La Cause du désir*, n° 93, 2016, p. 110.

¹⁰ Lacan J., « Note italienne », *Autres écrits*, Paris, Seuil, 2001, p. 311.

¹¹ Lacan J., *Le Séminaire*, livre XX, *Encore*, texte établi par J.-A. Miller, Paris, Seuil, 1975, p. 79.

¹² *Ibid.*, p. 65.

¹³ Lacan J., *Le Séminaire*, livre VII, *L'éthique de la psychanalyse*, texte établi par J.-A. Miller, Paris, Seuil, 1986, p. 181.

Siç e shohim, dashuria nuk është pa lidhje me idealin që përcjell tradita dhe që rregullon marrëdhëniet ndërmjet sekseve. Por ky rend i lashtë, « Era e babait », që strukturohet nga një logjikë vertikale, është zëvendësuar sot nga një logjikë horizontale, ajo e rrjetit në *Erën e jotë-gjithës*, siç shprehet Jacques- Alain Miller ¹⁴. Në një perspektivë të tillë, a do ta ndryshonte natyrën e picireve të dashurisë rikonfigurimi i qelizës martesore në modifikime të tilla si « polidashuria » apo « treshja » që zëvendësojnë dyshen standarte? Sido që të ishte, dhimbjet e dashurisë sot do të interpretoheshin ndryshe nga ato të një herë e një kohe. Ligjërimi i dashurisë, i kuptuar nisur nga mungesa, nga objekti i humbur apo nga ideali i paarrtshëm është zëvendësuar nga një tjetër ligjërim i cili e vendos dështimin në aksin imagjinar dominant- i dominuar. Gjatë kongresit të fundit të AMP Jacques-Alain Miller vuri në dukje ndikimin e tij mbi marrëdhëniet e dashurisë.

Atëherë kur fusha dukej e hapur dhe e favorshme ndaj risive shpërthyen shënjesit që i përkisnin fjalorit të luftës ndërmjet sekseve, që Lakani e kishte profetizuar më herët: kontroll, manipulim, dominim, detyrim, abuzim, *ghosting*... Përballë tyre propagandohet një formë dashurie që pretetendohet konsensuale, që bazohet në një akord të dyanshëm dhe që rregullohet kryesisht nga regjimi homeostatik i parimit të kënaqësisë. Lëvizjet feministe politizuan sferën private. Në emër të barazisë të subjekteve të së drejtës, ato kontribuan në futjen e ligjëritit juridik midis sekseve, gjë që rezultoi në të shumtën e rasteve për mirë. Por sot, bashkimi i neofeminizmit me ideologjinë viktimore, po na bën dëshmitarë të një politizimi të intimes. Ky politizim, që ka përqafuar normat e reja të ligjëritit, po sulmon një patriarkat tashmë në rënie. Lufta e sekseve po nxehet dhe në të shumtën e rasteve për keq. Por kur vuajtjet e dashurisë i atribuohen dominimit të një gjinie mbi tjetrën, domethënë të burrave mbi gratë, a mund të mos shohim këtu një formë të re të refuzimit të dashurisë dhe rreziqeve që kjo sjell? Së fundmi, suksesi botëror i filmit *Barbie* na e tregon këtë me siguri.

Në këtë kontekst, mbështetur nga ligjërimi i shkencës, vetëm ligjërimi analitik do t'i linte ende vend reales së erosit.

Një çështje strukture

¹⁴ Miller J.-A., *Le Séminaire*, livre VI, *Le désir et son interprétation*, texte établi par J.-A. Miller, Paris, La Martinière et le Champ freudien, 2013, quatrième de couverture

Por dashuria nuk ka lidhje vetëm me efektet e ligjërit, i cili ndryshon sipas epokës, ajo është gjithashtu një çështje strukture.

Falë pacienteve histerikeve, Frojdi u interesua shumë herët për fenomenin e dashurisë. Ai e studioi funksionimin e tij në plot raste. Në tekstin e tij « *Psychologie des foules et analyse du moi*¹⁵ », ai i kushtoi një kapitull të tërë gjendjes dashurore dhe hipnozës. Ai morri shembullin e dashurisë romantike të të riut për të ilustruar varfërimin e unit përballë objektit të çmuar, të ngritur në piedestalin e Idealit të unit. Në gjendjen dashurore, ky i fundit do të posedonte tërësinë e dashurisë së unit, duke e zhveshur unin nga çdo shpirt kritik. Frojdi e cilëson këtë fenomen si « vetësakrifikim » dhe e krahason atë me gjendjen nën hipnotizë. Fjalët që ai përdor janë të forta: përthithje e unit nga objekti, braktisje e unit, nënshtrim, magjepsje. Prandaj nuk është për t'u habitur që gjatë një zije, ndarje apo tradhëtie, subjekti ndihet sikur ti jenë amputuar pjesë të trupit - gjymtim që nuk vjen pa pjesën e tij të dhimbjes.

Në mësimet e tij të fundit, Lakani do ta pozicionojë dramën e dashurisë si të tillë nën vështirimin e takimit të dashurisë. Nuk kemi të bëjmë më me dy subjekte të mungesës-së-qënies, por me dy trupa folës « të prekur si subjekte të dijes së pavetëdijshme¹⁶ ». Në Seminarin *Encore*, ai shprehet: « Sepse nuk ka asgjë tjetër përveç takimit, takimit të partneri i simptomave, i emocioneve, i gjithçkaje që te çdo person shënon gjurmën e mërgimit të tij, jo si subjekt, por si folës, gjurmën e mërgimit të tij nga raporti seksual.¹⁷ » Te *L'os d'une cure*¹⁸ Jacques-Alain Miller shprehet se në këndvështirimin e mungesës së raportit seksual dhe si rrjedhim të partnerit simptomë, qeniet seksuale çiftohen në nivelin e ëndjes. Për sa i përket lidhjes simptomatike, ajo do të lidhej me strukturat shënjuese të trupit që përcaktojnë një partner si një mjet ëndjeje. Rrjedhimisht, është e nevojshme të bëhet dallimi mes strukturës e për-çdo x nga ajo e jo-çdo, e cila i ndan mënyrat mashkullore nga ato femërore të seksualizimit dhe përcakton llojin e partnerit simptomatik për secilin. Mjafton të thuhet se nga secila anë, as nuk ëndemi dhe as nuk vuajmë në të njëjtën mënyrë. Ne i atribuojmë qënies folëse mashkullore mënyrën fetishiste të ëndjes, në marrëdhënie me objektin *a*, dhe qënies folëse femërore pakufizimin e një ëndjeje në marrëdhënien e saj me A-në e ndarë. Prandaj, dashuritë që dhembin mund të ndahen sipas një logjike specifike për çdo pozicion seksual ose çdo seks. Për dikë, është dhimbja që lidhet me simptomat, e ngjashme me efektin e një ashkle që futet në mish. Për dikë tjetër, ajo e një

¹⁵ Freud S., « *Psychologie des foules et analyse du moi* », *Essais de psychanalyse*, Paris, Payot, 1981.

¹⁶ Lacan J., *Le Séminaire*, livre XX, *Encore*, op. cit., p. 131.

¹⁷ *Ibid.*, p. 132.

¹⁸ Miller J.-A., *L'os d'une cure*, Paris, Navarin éditeur, 2018.

pushtimi dhe shkatërrimi të plotë. Për njërin, mund të jetë shqetësimi i një jete dashurore të dyfishtë, tipike për restaurimin e saj. Për tjetrin, rreziku i një martese vdekjeprurëse me një demon ideal përtej partnerit real. Por dashuritë që dhembën lidhen po ashtu me mënyrën se si çdo trup folës mund të mbetet hermetik ndaj gjuhës së tjetrit.

Kështu, me emocion nuk kualifikojmë « zërin e trupit », ekspresivitetin e tij të natyrshëm, por sinjalin e një efekti të ëndjes që lidhet me gjurmën shënjtuese. Në një përvojë analitike, ne priremi të vëmë theksin në implikimin e shënjtuesit të emocioneve dhe, sipas shprehjes së Lakanit, nënvizuar nga Miller¹⁹, të « verifikojmë emocionin »²⁰. Nëse, në qasjen më klasike, bëhet fjalë për çlirimin e të vërtetës së ndrydhur, në kuptimin *e emocionit të gjurmuar në trup nga lalangue*, çështja që do të shtrohej do të kishte të bënte me izolimin e shenjës traumatike dhe ndikimit të saj në keqkuptimin ndërmjet sekseve.

Kur në praktikën tonë hasim raste të dashurive që dhembën, ne i ftojmë ato të lëshohen në rrjetën e shënjtuesve për ta bërë ëndjen të rezonojë me gjuhën.

Përktheu Eva Filaj

¹⁹ Miller J.-A., « Les affects dans l'expérience analytique », *op. cit.* p. 101.

²⁰ Lacan J., « Télévision », *op. cit.*, p. 524.